

**VENDIM I ASAMBLESE SE PERGJITHSME TE ORTAKEVE TE
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
ApNet SH.P.K.**

ApNetSh.p.k., eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe e regjistruar rregullisht sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ("QKB") me date 10/03/2020, me Numer Unik Identifikimi te Subjektit (NUIS) M02710403Udhe me seli ne adresen:Lagjja Kongresi Përmetit, Bulevardi "Jakov Xoxa", pallati nr. 5, kati nr. 1, Fier., Shqiperi, perfaqesuar ligjerisht nga Administratori i saj Kevin Lamçe(ketu e me poshte referuar si "Shoqeria").

Data: 26/12/2020

Vendi: Fier

Rendi i dites:

- Miratim i zmadhimitte kapitalit te Shoqerise.
- Ndryshim i Statutit te Shoqerise.
- Te Ndryshme.

Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise perbehet nga Ortaket e Shoqerise, si me poshte:

- 1) **INTEL MEDIA Sh.p.k.**, eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe e regjistruar rregullisht sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ("QKB") me date 03/04/2008, me Numer Unik Identifikimi te Subjektit (NUIS) K82803409T dhe me seli ne adresen: Lagja Apollonia,Rruga Sheshi Fitorja,prapa Foto Studio Rustemi, Fier, Shqiperi, perfaqesuar ligjerisht nga Administratori i saj Hamza Himo, ne cilesine e ortakut qe perfaqeson 15 % te kapitalit te regjistruar te Shoqerise **ApNet Sh.p.k.**;
- 2) **TEEB-CENTER Sh.p.k.**, eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe e regjistruar rregullisht sipas legjislacionit te Republikes. se Shqiperise, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ("QKB") me date 19/08/2004, me Numer Unik Identifikimi te Subjektit (NUIS) K43219401P dhe me seli ne adresen: Lagjja Kongresi i Permetit, Bulevardi Jakov Xoxa, Pallati nr 5 Kati i I-re, Fier, Shqiperi, perfaqesuar ligjerisht nga Administratori i saj Ilir Nathanaili ne cilesine e ortakut qe perfaqeson 85 % te kapitalit te regjistruar te Shoqerise **ApNet Sh.p.k.**;

MEQENESE:

- A. ApNet Sh.p.k., eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe e regjistruar rregullisht sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, me kapital te regjistruar 100, 00 (njeqind) Leke, i ndare ne 2(dy) kuota, te cilat perfaqesojne 100% (nje qind perqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqerise, te zoteruara nga Ortaket e saj sipas percaktimeve te mesiperme;
- B. Ortaku **INTEL MEDIA Sh.p.k** ka miratuar rregullisht Raportin e Vleresimit te Aseteve date 26/12/2020 te pergatitur nga Studio "Load" Sh.p.k, dhe destinimin e ketyre aseteve me vlere 9,085,000 (nëntë milion e tetëdhjetëepesë mijë) Lekëleke si kontribut ne natyre ne kapitalin e shoqerise ApNet;
- C. Ortaku **TEEB-CENTER Sh.p.k.**, ka miratuar rregullisht Raportin e Vleresimit te Aseteve date 26/12/2020 te pergatitur nga Studio "Load" Sh.p.k, dhe destinimin e ketyre aseteve me vlere 40,882,565 (dyzetë milion e tetëqindetëdhjetëdy mijë e pesëqindegjashtëdhjetëepesë) Lekë si kontribut ne natyre ne kapitalin e shoqerise ApNet;
- D. Sipas Nenit 6 te Statutit, zmadhimi i kapitalit te Shoqerisemund te kryhet me Vendim te Asamblese se Pergjithshme, permes kontributeve ne para apo ne natyre. Kontributet ne natyre duhet te shoqerohen me nje raport te kryer nga nje ekspert i vleresimit te kontributeve ne natyre;
- E. Sipas Nenit 14 pika (2) vendimet qe kane te bejne me zmadhimin e kapitalit te Shoqerise si edhe me ndryshimet e neneve te statutit konsiderohen si vendime te jashtezakonshme qe merren nga Asambleja e Pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne prani te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave;
- F. Jane plotesuar te gjitha kushtet per mbajtjen e Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme, e cila eshte thirrur dhe organizohet ne perputhje me Statutin dhe Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ("**Ligji Tregtar**") i ndryshuar.

PER SA ME SIPER, Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise, VENDOSI:

- I. Te miratoje zmadhimin e kapitalit te Shoqerisenga 100.00 (njeqind) Lekeme vleren 49,967,565 (dyzet e nente milion e nenteqind e gjashtedhjetë e shtate mije, peseqind e gjashtedhjetë e pese) Leke sipas Raporteveperkatese te Vleresimit te Studio LOAD sh.p.k, si me poshte vijon:

- a. 18.18% (tetembedhjetë, pike tetembedhjetë perqind) e zmadhimit kapitalit është shlyer në natyrë nga ortakët INTEL MEDIA Sh.p.k, në vlerën e barabartë 9,085,000 (nëntë milion e tetëdhjetëpesë mijë) Lekë;
- b. 81.82% (tetedhjetë e një, pike tetedhjetë e dy perqind) e zmadhimit kapitalit është shlyer në natyrë nga ortakët TEEB-CENTERSH.p.k, në vlerën e barabartë 40,882,565 (dyzetë milion e tetëqindtetëdhjetë e pesëqind e pesëqind e gjashtëdhjetëpesë) Lekë;

II. Te miratojë kapitalin e ri dhe vlerën nominale të kuotave të zotëruara nga Ortakët e Shoqërisë, të cilat pas zmadhimit të kapitalit janë si më poshtë:

- a. INTEL MEDIA Sh.p.k, zotëron 1 (një) kuota në vlerën e barabartë me 9,085,015 (nëntë milion e tetëdhjetëpesë mijë e pesëmbëdhjetë) Leke, dhe që përfaqëson 18.18% (tetembedhjetë, pike tetembedhjetë perqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- b. TEEB-CENTERSH.p.k,, zotëron 1 (një) kuota në vlerën e barabartë me 40,882,650 Leke (dyzetë milion e tetëqindtetëdhjetë e pesëqind e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 81.82% (tetedhjetë e një, pike tetedhjetë e dy perqind) të kapitalit të Shoqërisë.

III. Te ndryshojë Statutin e Shoqërisë në lidhje me Nenin 5 të tij, si vijon:

“Neni 5. Kapitali themeltar dhe Ortakët e Shoqërisë

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 49,967,665 (dyzet e nente milion e nenteqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë, gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Leke dhe është i ndarë në 2 kuota.
- 5.2 Secili Ortakë ka vendosur kontributin e tij në natyrë për kapitalin e Shoqërisë, shoqëruar me një raport vlerësimi teknik të kryer nga një ekspert i vlerësimit të kontributeve në natyrë.
- 5.3 Ortakët kanë miratuar ekspertin Studio LOAD sh.p.k, regjistruar si person juridik me përgjegjësi të kufizuar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës me Nr. 26075 Vendimi, datë 09.07.2001 me Nr. Licence Vsh. 0003/3, me administratorë të saj Znj. Yljana Dhozhi (Sejfo), dhe deklarojnë se janë dakord me aktet e ekspertit. Si rrjedhim ortakët deklarojnë se kapitali i shoqërisë është 49,967,665 Leke: 18.18% (tetembedhjetë, pike tetembedhjetë perqind) është shlyer në natyrë nga ortakët INTEL MEDIA sh.p.k; 81.82% (tetedhjetë e një, pike tetedhjetë e dy perqind) është shlyer në natyrë nga ortakët TEEB-CENTER Sh.p.k.

Ne perfundim, ortakët e Shoqërisë dhe kuotat përkatëse të tyre janë si më poshtë:

INTEL MEDIA Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e regjistruar rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Biznesit ("QKB") me datë 03/04/2008, me Numer Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS) K82803409T dhe me seli në adresën: Lagja Apollonia, Rruga Sheshi Fitorja, prapa Foto Studio Rustemi, Fier, Shqipëri, në cilësinë e ortakut që zoteron 1 kuotë të barabartë me 9,085,015 (nëntë milion e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëmbëdhjetë) Leke, dhe që përfaqëson 18.18% (tetëmbëdhjetë, pike tetëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë;

TEEB-CENTER Sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e regjistruar rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Biznesit ("QKB") me datë 19/08/2004, me Numer Unik Identifikimi të Subjektit (NUIS) K43219401P dhe me seli në adresën: Lagja Kongresi i Permetit, Bulevardi Jakov Xoxa, Pallati nr 5 Kati i I-re, Fier, Shqipëri, në cilësinë e ortakut që zoteron 1 kuotë të barabartë me 40,882,650 Leke (dyzetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lekë, dhe që përfaqëson 81.82% (tetëdhjetë e një, pike tetëdhjetë e dy përqind) të kapitalit të Shoqërisë;

- 5.4 *Vlera e kuotës së secilit ortak dhe përqindja e pjesëmarrjes që ortakët zoteron në kapitalin e Shoqërisë regjistrohet në librin e ortakëve të Shoqërisë.*
- 5.5 *Përgjegjësia e ortakëve për mbulimin personalisht të humbjeve të Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pasqyruar të kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë".*

IV. Te autorizojë Administratorin e Shoqërisë të ekzekutojë dhe të shpërndajë çdo dokument të nevojshëm për të zbatuar këtë vendim dhe në përgjithësi të bëjë çdo gjë të nevojshme për të regjistruar këtë Vendim dhe për të përmbushur qëllimin e tij si dhe t'a regjistrojë këtë Vendim në Librin e Ortakëve.

Ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të përbërë nga Ortakët e Shoqërisë, nuk u mor asnjë vendim tjetër, e cila u mbyll sot më 26/12/2020, në orën 13:00.

ORTAKËT

INTEL MEDIA Sh.p.k TEEB-CENTER Sh.p.k

Administrator


Hamza Himzo

Administrator


Ilir Nathanaili